



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Drejtoria e Arsimit dhe e Shkencës
Direktorijati za Obrazovanje i Nauku
Eđitim ve Bilim Muderlugu



DKA Nr. 2407/24 24.12.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Datë: 24.12.2024

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT – PRIZREN

Raport i punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren për vitin 2024

Në këtë raport janë pasqyruar aktivitetet, projektet dhe punët e kryera në DKA në periudhën janar – dhjetor 2024.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren në përputhje me Planin Dinamik për periudhën janar– dhjetor për vitin 2024, bazuar në planifikimin e sektorëve në DKA mbi detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, ka planifikuar dhe realizuar aktivitete dhe projekte të ndryshme. Në këtë raport përfshihen punët administrative, monitorimi dhe mbikqyrja e shkollave, rekomandime për shkollat, përgjigjet e vendimeve për transferimin e nxënësve të shkollave mesme të larta, procedurat e ndërtimit të objekteve shkollore, anekseve, riparimeve, mirëmbajtjen e objekteve dhe ambienteve shkollore, projektet që lidhen me sigurinë në shkolla, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve, etj.

Raporti për periudhën janar – dhjetor për vitin 2024 është përpiluar nga raportet e aktiviteteve, projekteve të realizuara dhe punëve të tjera të kryera nga DKA gjatë kësaj periudhe. Në këtë raport janë përmbledhur të dhënat e sektorit të arsimit, administratës e financave, aktivitetet dhe punëtoritë e zhvilluara në vitin 2024.

Luljeta Veselaj Gutaj
Drejtoreshë e DKA-së në Prizren
Tel. 03820035321
E-mail: Luljeta.Veselaj@rks-gov.net

Hyrje

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren në përputhje me Planin Dinamik të saj për periudhën janar – dhjetor 2024, dhe bazuar në planifikimin e sektorëve në DKA mbi detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, ka planifikuar dhe realizuar aktivitete e projekte të ndryshme.

1. Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave - Udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunës.

-Përgjatë vitit 2024 është punuar në Planin Zhivillimor të Arsimit për vitin 2025/2027 i cili është aprovuar në muajin nëntor 2025, me çka është lehtësuar qeverisja dhe menaxhimi i shkollave si dhe puna e edukatorëve dhe mësimeve.

- Është hartuar “**Strategjia për sigurinë në institucionet edukative arsimore në Komunën e Prizrenit**”, është në fazën e dëgjimit publik për të vazhduar mëtej në asamble për aprovim.

-Është punuar drafti për “Planin e Veprimit për EPBRM”, së shpejti do të jetë në dëgjim publik

2. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja - Bashkëpunim cilësor dhe efikas ndërmjet hisedarëve të edukimit parashkollor

-Po punohet në procesin e identifikimit të institucioneve parashkollore private. Janë mbajtur disa takime koordinuese me Inspektoratin e Arsimit, ku janë duke u koordinuar vizitat dhe mbledhja e të dhënave.

-Bashkë me agjencitë zhvillimore është duke vazhduar përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta. DKA ka vazhduar marrëveshjen me ‘Caritas Kosova’ për dhënie të shërbimeve profesionale psikologjike për fëmijët me nevoja të veçanta. Gjithashtu vazhdon bashkëpunimi edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare (Unicef, SCIK etj) për të përmirësuar shërbimet arsimore për nxënësit në nevojë.

-Është funksionalizuar Institucioni i edukimit të hershëm në lagjen “Bajram Curr”, poashtu po bëhen përgatitjet për hapjen e çerdhes në

lagjen Ortakoll.

-Po vazhdon realizimi i arsimit joformal i filluar në vitin paraprak.

-Përmes garave dhe aktiviteteve të tjera ndërkulturore, është duke u promovuar multikulturalizmi dhe diversiteti në arsimin parauniversitar.

3. Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve - Zhvillim i vazhdueshëm i kapaciteteve për mësimitdhënie cilësore

-Bashkë me shkollat identifikuar nevojat për zhvillimin profesional të personelit arsimor. Dka organizuar trajnime profesionale me qëllim të mështetjes së komunitetit arsimor, ndërsa përmes organizatave të tjera janë duke u organizuar trajnime në fushat deficitare etj.

4. Zbatimi i kurrikulës së re - Ndërtim i vazhdueshëm i kapaciteteve dhe i mekanizmave për zbatim dhe monitorim të kurrikulës së re

-Është intensifikuar shërbimi i këshillëdhënies për shkollat lidhur me zbatimin e KKK. Përmes drejtorëve dhe koordinatorëve të cilësisë shkollat marrin këshilla nga DKA për modalitetet e zbatimit të KKK, për sfidat e zbatimit dhe për zgjidhjet e mundshme të problemeve *ad-hoc* të zbatimit të KKK. Gjithashtu shkollat vazhdimisht furnizohen me materiale pune, me udhërrëfyes dhe dokumentacion të domosdoshëm për zbatimin e KKK.

5. Sigurimi i cilësisë - Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimitdhënies dhe mësimitnxënies në shkolla

-Vazhdon përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë. Përmes MASHT dhe agjencive zhvillimore koordinatorët e cilësisë me bazë në shkollë marrin trajnime relevante dhe ndërtojnë kapacitetet për zbatim të KKK dhe rritjes së cilësisë së mësimitdhënies dhe të nxënies në shkollat e komunës.

Meqenëse është duke u shtuar përdorimi i mjeteve digjitale në funksion të mësimitdhënies dhe nxënies, 20 shkolla janë furnizuar me pajisje teknologjike nga DKA, me mbështetje të Ambasadës Turke dhjetë shkolla janë pajisur me 29 tabela inteligjente.

Me bashkëfinancim me Kosova Makers League 43 shkolla fillore janë paisur me nga katër robot edukativ.

-Me bashkëfinancim me IOM disa shkolla janë pajisur me kabinete fizike, kimie, biologjie dhe gjeografie bazuar në nevojat e shkollave.

-Për vitin shkollor 2023-2024 Drejtoria Komunale e Arsimit ka dhënë 176 bursa me vlerë në 700 euro.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka ndarë 35 bursa nga 300 euro për nxënës të shkollave të mesme për fëmijët e invalidëve të luftës si dhe për 16 nxënës me nevoja të veçanta. Për 90 nxënës udhëtarë është rritur numri i bursave si dhe është shtuar vlera e bursës nga 300 euro .

I. Të dhënat statistikore

Në fillim të vitit shkollor 2023/2024 në institucionet publike të menaxhuara nga Komuna e Prizrenit ndjekin mësimin 25882 nxënës, të gjitha shkollat publike me paralelet e ndara, në të tri nivelet e arsimit (0, 1, 2 dhe 3) nga edukimi i herëshëm (fëmijë të moshave 3-4 vjeç) deri në shkollat e mesme të larta (klasa e 12), janë si në tabelarin e mëposhtëm.

Të dhënat e numrit të nxënësve në Komunën e Prizrenit për vitin shkollor 2024-2025:

Numri i nxënësve në institucionet publike të komunës së Prizrenit për vitin shkollor 2024 – 2025													
Niveli i edukimit të hershëm		Niveli fillor					Niveli i mesëm i ulët				Niveli i mesëm i lartë		
Parashkollorë (Mosha 3-4 vjeç dhe 4-5 vjeç)	Parafillorë	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
342	1478	2001	2051	1971	2049	2095	2008	2152	1971	2024	2110	1832	1798
													Gjithsej
Në nivelin e edukimit të hershëm (mosha 3-5 vjeç dhe mosha 5-6 vjeç)											1.820		
Në nivelin fillor (Klasa I - V)											10.167		
Në nivelin e mesëm të ulët (Klasa VI – IX)											8.155		
Në nivelin e mesëm të lartë (Klasa X – XII)											5.740		
Për të gjitha nivelet											Totali		
											25.882		

Nr.	KUADRI	SHQIP		BOSHNJAK		TURQ		ROM		GJITHSEJ		GJITHSEJ
		M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
1	EDUKATOR	1	67	/	9	/	6	/	3	1	85	86
2	MËSUES (I -V)	101	397	52	22	1	32	1	1	155	452	607
3	ARSIMTAR (VI-IX)	361	334	80	30	15	21	/	/	456	385	841
4	MËSIMDHËNËS (X-XII)	162	112	19	13	11	13	/	/	192	138	330
5	DREJTOR	36	18	6	1	/	/	/	/	42	19	61
6	ZV.DREJTOR	3	2	/	/	3	/	/	/	6	2	8
7	SEKRETAR	11	10	/	/	/	/	/	/	11	10	21
8	PSIKOLOG	1	7	/	/	/	/	/	/	1	7	8
9	PEDAGOG	5	2	/	/	/	/	/	/	5	2	7
10	BIBLIOTEKIST	5	6	/	/	/	/	/	/	5	6	11
11	STAF MBËSHTETES	193	21	20	8	11	1	/	7	221	41	262
	TOTALI	879	977	179	86	35	77	14	23	1107	1163	2270

Struktura e të punësuarëve në Drejorinë Komunale të Arsimit në Prizren në vitin shkollor: 2024/2025

Statistika e numrit të nxënësve sipas etnisë në Komunën e Prizrenit për vitin shkollor 2024/2025

Numri i nxënësve sipas komuniteteve në Komunën e Prizrenit 2024 - 2025															Gjithsej
Etnia	Niveli i edukimit të hershëm		Niveli fillor					Niveli i mesëm i ulët				Niveli i mesëm i lartë			
	Para shko llorë	Para fillor ë	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Shqiptarë	322	1245	1722	1734	1694	1770	1766	1708	1837	1692	1680	1838	1614	1534	22156
Boshnjak ë	8	77	108	128	110	110	139	136	143	157	157	117	122	141	1653
Turq	7	117	92	120	99	107	118	90	112	80	129	153	94	119	1437
Rom, ashkali, egjiptian	1	39	79	69	68	62	77	74	60	42	58	2	1	4	636
GJITHSE J	338	1478	2001	2051	1971	2049	2100	2008	2152	1971	2024	2110	1831	1798	25882

Gjithsej në nivelin e edukimit të hershëm	Shqiptarë	1567	Boshnjakë	85	Turq	124	Rom, ashkali, egjiptian	40
Gjithsej në nivelin fillor klasa 1-5	Shqiptarë	8686	Boshnjakë	595	Turq	536	Rom, ashkali, egjiptian	355
Gjithsej në nivelin e mesëm të ulët klasa 6-9	Shqiptarë	6917	Boshnjakë	593	Turq	411	Rom, ashkali, egjiptian	234
Gjithsej në nivelin e mesëm të lartë klasa 10-12	Shqiptarë	4986	Boshnjakë	380	Turq	366	Rom, ashkali, egjiptian	7

Arsimi i komuniteteve

Drejtorët e shkollave të komuniteteve dhe shkollave në të cilat zhvillohet mësimi edhe në gjuhët e komuniteteve përkatëse, raportojnë në DKA në mënyrë periodike për sfidat dhe ecurinë e procesit edukativo - arsimor. Një ndër sfidat kryesore në shkollat ku zhvillohet mësimi në gjuhët e komuniteteve është furnizimi me tekste shkollore nga MASHTI. Mungesa e teksteve shkakton vështirësi në procesin mësimor për nxënësit e komuniteteve. Shkollat janë udhëzuar të përdorin burime alternative.

Numri i nxënësve sipas komuniteteve në kopshite, shkolla dhe kolegje private në komunën e Prizrenit është:

Numri i nxënësve sipas komuniteteve në Komunën e Prizrenit 2024 - 2025															Gjithsej
Etnia	Niveli i edukimit të hershëm		Niveli fillor					Niveli i mesëm i ulët				Niveli i mesëm i lartë			
	Para shkollore	Para fillorë	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Shqiptarë	322	1245	1722	1734	1694	1770	1766	1708	1837	1692	1680	1838	1614	1534	22156
Boshnjakë	8	77	108	128	110	110	139	136	143	157	157	117	122	141	1653
Turq	7	117	92	120	99	107	118	90	112	80	129	153	94	119	1437
Rom, ashkali, egjiptian	1	39	79	69	68	62	77	74	60	42	58	2	1	4	636
GJITHSEJ	338	1478	2001	2051	1971	2049	2100	2008	2152	1971	2024	2110	1831	1798	25882

Gjithsej në nivelin e edukimit të hershëm	Shqiptarë	1567	Boshnjakë	85	Turq	124	Rom, ashkali, egjiptian	40
Gjithsej në nivelin fillor klasa 1-5	Shqiptarë	8686	Boshnjakë	595	Turq	536	Rom, ashkali, egjiptian	355
Gjithsej në nivelin e mesëm të ulët klasa 6-9	Shqiptarë	6917	Boshnjakë	593	Turq	411	Rom, ashkali, egjiptian	234
Gjithsej në nivelin e mesëm të lartë klasa 10-12	Shqiptarë	4986	Boshnjakë	380	Turq	366	Rom, ashkali, egjiptian	7

Shkollat private	Shqiptarë			Turq			Boshnjakë			Goranë			Tjetër...			Gjithsej
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	G	M	F	Gj	M	F	Gj	
"Asociation Loyola-Gymnasium"	217	191	408	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	408
Loyola	374	354	728	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	728
Mehmet Akif 1	259	257	516	6	5	11	7	1	8	1	1	2	0	0	0	537
Perspektiva	36	23	59	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	59
Nëna Kabrini	54	63	117	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	2	3	120
International Maarif Schools of Kosova 1	173	158	331	24	22	46	10	12	22	0	0	0	0	0	0	399
Kopshti i fëmijëve Buzëqeshja	26	24	50	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	50
Perspektiva-T	40	47	87	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	87
Ardhmëria	17	18	35	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	35
Tingulli i Artë	17	18	35	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	35
Cennet Bahçesi	19	11	30	8	12	20	0	0	0	0	0	0	0	0	0	50
Gjithsej	1232	1164	2396	38	39	77	17	13	30	1	1	2	1	2	3	2508

Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

DKA ka shtuar numrin e psikologëve në shkolla, dhe asistentëve për fëmijët/nxënësit me nevoja të të veçanta. Janë trajnuar mësuesit dhe asistentët për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta për çështje që lidhen me gjithëpërfshirje. Në bashkëpunim me organizata të ndryshme janë krijuar qendra mësimore për fëmijë me nevoja të veçanta, si dhe është shtuar numri i mësuesve mbështetës. Në bashkëpunim me organizatat vendore dhe ndërkombëtare janë krijuar dhe zbatuar programe dhe projekte në fushën e arsimit, sidomos për fëmijët me nevoja të veçanta.

DKA ka themeluar dhe funksionalizuar komisionin për vlerësim të fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe ka krijuar databazën me të dhëna, ku pasqyrohen në mënyrë të hollësishme llojet dhe shkalla e dëmtimeve. Brenda vitit 2024 ekipi vlerësues ka kryer vlerësimin sipas UA të MASHTI-t, ndërsa po punohet me plane individuale të arsimit në klasa ku ka fëmijë me nevoja të veçanta.

Gjithpërfshirja

Në bashkëpunim me MASHTI-n dhe OJQ-të e ndryshme janë mbajtur punëtori dhe trajnime sensibilizuese dhe edukuese me temë të gjithpërfshirjes. Kërkohet më shumë angazhim nga prindërit e tyre, institucionet lokale, qendrore dhe nga OJQ-të. Çështja e vijueshmërisë është duke u trajtuar për fëmijët në rrugë edhe më tej, më shumë vëmendje për të përmirësuar çështjen e gjithpërfshirjes.

DKA ka shtuar numrin e psikologëve në shkolla, dhe asistentëve për fëmijët/nxënësit me nevoja të të veçanta. Janë trajnuar mësimitdhënësit dhe asistentët për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta për çështje që lidhen me gjithpërfshirje. Në bashkëpunim me organizata të ndryshme janë krijuar qendra mësimore për fëmijë me nevoja të veçanta, si dhe është shtuar numri i mësimitdhënësve mbështetës. Në bashkëpunim me organizatat vendore dhe ndërkombëtare janë krijuar dhe zbatuar programe dhe projekte në fushën e arsimit, sidomos për fëmijët me nevoja të veçanta.

DKA ka themeluar dhe funksionalizuar komisionin për vlerësim të fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe ka krijuar databazën me të dhëna, ku pasqyrohen në mënyrë të hollësishme llojet dhe shkalla e dëmtimeve.

Sfidat:

- Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të mësimitdhënësve në lidhje me arsimin gjithpërfshirës;
- Trajnimi i mësimitdhënësve, mësimitdhënësve mbështetës dhe asistentëve të angazhuar në klasat ku ka nxënës të komuniteteve;
- Zgjerimi i njohurive të mësimitdhënësve rreth praktikave moderne në fushën e arsimit gjithpërfshirës;
- Braktisja e nxënësve vazhdon të jetë sfidë. Kjo vjen si pasojë e gjendjes së rënduar ekonomike të familjeve të nxënësve të komuniteteve;
- Indiferenca e prindërve të nxënësve të komunitetit Rom, Ashkali, Egjiptas;
- Çështja e vijueshmërisë duhet të trajtohet edhe më tej edhe pse situata është përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme.

Standardet në arsim - Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Përmes formularëve të vlerësimit të kapaciteteve të DKA-së për sektorin e arsimit janë përshkruar trajnimet e mësimitdhënësve:

- Në kuadër të projektit "Avancimi i cilësisë së arsimit në Komunen e Prizrenit" janë mbajtur trajnime të cilat i kanë ndjekur 450

mësimdhënës, edukatore të institucioneve shkollore të komunës së Prizrenit. Përmes këtij projekti komuniteti arsimor kanë rritur aftësitë dhe kapacitetet e tyre në planifikimin dhe zbatimin e orës mësimore përmes lojës; gjithëpërfshirjes; të menduarit kritik dhe kreativ; vlersim formativ dhe PIA.

- SBASHK-u në vitin 2024 ka bërë trajnimin e mbi 500 mësimdhënësve në fusha deficitare.
- Trajnimi i 25 drejtuesve të shkollave dhe mësimdhënësve me temë “MoviEQ”. Ky projekt është realizuar në bashkëpunim me IOM;
- Trajnimi i 30 mësimdhënësve, psikolog e drejtor/e të shkollave fillore dhe të mesme me temë “Shprehitë për adoleshencën”. Ky projekt është realizuar në bashkëpunim me organizatën ‘Lions International’;
- Trajnimi i mësimdhënësve me temë "Edukimi seksual dhe riprodhues". Ky trajnim është kryer në bashkëpunim me IP i Kosovës dhe përfaqësues të MASHTI;
- Janë trajnuar 190 mësimdhënës në bashkëpunim me Korpusin e Paqes në Kosovë, “Bëjeni mësimin e nxënësve real dhe efektiv!”. Ky trajnimi ka eksploruar teoritë dhe praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve të bazuar në kompetenca, me qëllim të mbështetjes të zbatimit të Kurrikulës së Kosovës.
- Trajnimi i 100 mësimdhënësve, të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta me temë “Metodologjitë interaktive”. Ky projekt është realizuar në bashkëpunim me organizatën ‘QEHT KONICA’;
- Trajnimi i 43 mësimdhënësve të fushës së IT “Maqueen Plus” dhe “Scratcht” ,realizuar në bashkëpunim me organizatën “Kosova Makers League”;
- Trajnimi i 120 mësimdhënësve mbështetur nga Instituti për Promovimin e Edukimit – IPEDU me temë “Të drejtat tona”

Qeverisja e arsimit në komunë – Struktura menaxheriale

Në dhjetë vitet e fundit arsimit në Kosovë ka qenë sfidë në vete. DKA po vazhdon me procesin e riorganizimit si njësi menaxheriale e arsimit në komunë. Dinamizimi i arsimit ka nxjerrë nevojën për riorganizim dhe ristrukturim të DKA-së për t’iu përgjigjur ndryshimeve në sektorin e arsimit. Bazuar në organogramën e re, janë caktuar detyrat dhe përgjegjësitë të punonjësve të DKA-së.

Shërbimi ligjor në DKA

Zyra ligjore në DKA për periudhën janar - dhjetor 2023 ka ndihmuar komunitetin arsimor, prindërit dhe nxënësit me një sërë shërbimesh ligjore, përmes ndihmës juridike.

Llojet e shërbimeve:

- 335 Vendime të ndryshme, si: pushim të lehonisë, pushime papagesë, ndërprerje të mardhënjes së punës me vetëdëshirë, përfundimi i kontratës së punës, punëtorët arsimor që shkojnë në pension, punëtorët arsimor që ndërrojnë jetë, pagat percjellëse me rastin e daljes në pension, formime të komisioneve, pranime teknike etj.
- 147 Përgjigje me shkrim palëve të ndryshme, për situata të ndryshme
- 166 Pëlqime për studentët dhe OJQ në lidhje me implementimet e projekteve nëpër shkolla
- 2121 Lëndë janë percjellë në zyrën e përfaqësimit ligjorë në Komunën e Prizrenit, në lidhje me përfaqësimin e DKA-së në Gjykatë,
- 832 Përgjigje në padi zakonisht për paga jubilarë, pagesën e shujtës, kompensimin e kualifikimit për licenc, kompensimin e inflacionit, ditëve të vikendit, punë jashtë orarit të punës, orët e kujdestarisë dhe për mbajtjen e grevës.
- 4 Parashtresa për Gjykatën Themelore në Prizren
- 15 Kërkesa
- 6 Rekomandime
- 5 Vërtetime
- 5 Njoftime
- 2 Referenca
- 8 Autorizime
- Memorandume të bashkëpunimit dhe marrëveshje të bashkëpunimit
- 129 konkurse për mësimdhënës
- 20 konkurse për punëtor teknik
- 2 qasje në dokumenta publike

Menaxhimi i financave

- Në fillim të vitit 2024 është kryer plani i zotimeve dhe shpenzimeve, pasqyra e ndarjes së buxhetit të shkollave për kategorinë e pagave dhe shërbimeve komunale të cilat i janë dërguar shkollave. DKA në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave është përgatitur për fillimin e vitit të ri fiskal me udhëzimet që rrjedhin nga thesari.
- Janë realizuar zotimet e mjeteve për kategoritë ekonomike sipas kërkesave të shkollave. Deri në përmbyllje të vitit fiskal 2024 janë zotuar **1781** lëndë, për të gjitha kategoritë shpenzuese si dhe janë përgatitur raporte periodike sipas nevojës për institucionet shkollore, përkatësisht janë njoftuar shkollat për buxhetin e alokuar dhe shpenzimet sipas kërkesave të tyre.
- Janë përpunuar ndryshimet në listat e pagave për periudhën janar- dhjetor 2024 dhe janë procesuar kërkesat e shkollave sipas pasqyrës së mëposhtme, ku në bazë të këtyre të dhënave sektori i financave për këtë periudhë ka proceduar gjithsej **1738** lëndë.

. Pasqyrë e realizimit të pagesave ne sistrem te pagave						
Muaj	Puntorë të rinjë	Pagesa retroaktive /ore jashtë orarit	Ndryshime	Tranfere bankare	Ndalesa në page	Largime nga lista e pagave
Janar	11	5	27	15		10
Shkurt	6	7	38	6	1	9
Mars	0	87	34	9		10
prill	15	4	28	2	0	6
maj	22	0	24	4		7
qershor	17	1	25	5	1	17
korrik	17	243	42	6	2	12
gusht	16	23	41	5	0	13
shtator	11	84	30	5	1	12
tetor	5	58	77	9	0	11
nentor	1	248	38	8	16	11
dhjetor	<u>12</u>	<u>178</u>	<u>33</u>	<u>9</u>	<u>1</u>	<u>7</u>
Gjithsej	<u>133</u>	<u>938</u>	<u>437</u>	<u>83</u>	<u>22</u>	<u>125</u>
						<u>1738</u>

- Në bazë të raportit përmbledhës të shpenzimeve për paga të institucioneve shkollore për periudhën I vjeçare janë bërë pagesa me vendime gjyqësore me vlerë 1,096,794.36€ në kategorinë e pagave të arsimit fillor në kuadër të kompensimit të shujtave për mësimdhënësit. Këto ekzekutime kanë vazhduar të dëmtojnë buxhetin e arsimit me vite. Pagesa me vendime gjyqësore ka pasur edhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve me vlerë 171,413.81€ si dhe investimeve kapitale 95140.10€
- Në kuadër të angazhimit të sektorit të financave në bashkëpunim me zyrtarin kryesor financiar, DKA iu është përgjigjur kërkesave të auditorit në lidhje me pagesat me vendime gjyqësore të vitit të kaluar.
- Ka vazhduar bashkëpunimi me zyrtarë të departamentit të buxhetit lidhur me të dhënat e kërkuara për stafin aktual dhe janë

përcjellur pasqyra me të dhënat e kërkuara.

- Është përfunduar procesi I planifikimit të buxhetit 2025-2027 në të cilën janë evidentuar kërkesat buxhetore të shkollave sipas qarkoreve buxhetore 2025 në sistemin e zhvillimit dhe menagjimit të buxhetit (SZHMB)
- Me përfundimin e vitit fiskal sektori i financave ka analizuar gjendjen mbi ecurinë e shpenzimeve në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm përkatësisht realizimin e buxhetit dhe ka përgatitur pasqyren e shpenzimeve ku janë paraqitur të dhënat e shkollave për realizimin e buxhetit sipas planifikimit.
- Shpenzimet nga **granti qeveritar dhe te hyrat për të gjitha kategorit** për programin e arsimit janë realizuar mbi 99.8 % të cilat janë paraqitur sipas tabelës dhe grafikut të poshtëshënuar:

Pasqyrë e realizimit të buxhetit për programet e arsimit për viti 2024						
Përshkrimi	Buxheti Aktual	Shpenzimet	Zotim /Obligimet	Mjete te lira	Alokimi Suficid/Deficid	% e realizimit te buxhetit
622 PRIZREN	23,458,750.45	23,405,611.31	40,710.18	12,428.96	23,458,750.45	99.8
92050 ADMINISTRATA - PRIZREN	1,016,685.05	1,005,345.76	11,109.20	230.09	1,016,685.05	98.9
92390 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET- PRIZREN	819,952.49	819,234.44	11.45	706.60	819,952.49	99.9
93270 ARSIMI FILLOR - PRIZREN	18,174,517.04	18,135,564.74	28,892.01	10,060.29	18,174,517.04	99.8
94470 ARSIMI I MESËM - PRIZEREN	3,447,595.87	3,445,466.37	697.52	1,431.98	3,447,595.87	99.9
21 TE HYRAT VETANAKE	945,549.42	930,403.15	15,075.67	70.60	945,549.42	98.4


22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	119,807.73	116,013.41	766.00	3,028.32	119,807.73	96.8
--	------------	------------	--------	----------	------------	------

Pasqyrë e e realizimit të buxhetit për programet e arsimit për viti 2024

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Shpenzimet	Zotim /Obligimet	Mjete te lira	% e realizimit te buxhetit
622 PRIZREN	23,458,750.45	23,405,611.31	40,710.18	12,428.96	99.77
92050 ADMINISTRATA - PRIZREN	1,016,685.05	1,005,345.76	11,109.20	230.09	98.88
111 PAGA DHE SHTESA	122,931.05	122,931.05	0.00	0.00	100.00
130 MALLRA DHE SHËRBIME	893,754.00	882,414.71	11,109.20	230.09	98.73
92390 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET- PRIZREN	819,952.49	819,234.44	11.45	706.60	99.91
111 PAGA DHE SHTESA	391,339.99	391,339.99	0.00	0.00	100.00
130 MALLRA DHE SHËRBIME	34,912.00	34,626.91	11.29	273.80	99.18
132 SHPENZIME KOMUNALE	6,000.50	5,743.81	0.00	256.69	95.72

300 PASURITË JOFINANCIARE	387,700.00	387,523.73	0.16	176.11	99.95
93270 ARSIMI FILLOR - PRIZREN	18,174,517.04	18,135,564.74	28,892.01	10,060.29	99.79
111 PAGA DHE SHITESA	15,684,147.54	15,684,147.54	0.00	0.00	100.00
130 MALLRA DHE SHËRBIME	826,442.00	816,263.55	5,713.96	4,464.49	98.77
132 SHPENZIME KOMUNALE	164,800.50	164,549.84	206.43	44.23	99.85
300 PASURITË JOFINANCIARE	1,499,127.00	1,470,603.81	22,971.62	5,551.57	98.10
94470 ARSIMI I MESËM - PRIZEREN	3,447,595.87	3,445,466.37	697.52	1,431.98	99.94
111 PAGA DHE SHITESA	3,015,992.87	3,015,992.87	0.00	0.00	100.00
130 MALLRA DHE SHËRBIME	375,867.00	374,191.76	397.52	1,277.72	99.55
132 SHPENZIME KOMUNALE	55,736.00	55,281.74	300.00	154.26	99.18
21 TE HYRAT VETANAKE	945,549.42	930,403.15	15,075.67	70.60	98.40
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	119,807.73	116,013.41	766.00	3,028.32	96.83

Përqindja e realizimi të buxhetit për arsim



Shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për të gjitha programet janë realizuar sipas të dhënave të poshtë shënuara

- Në **arsimim parafillor** për mallra dhe shërbime nga granti janë shpenzuar ose 99.18% të mjeteve të ndara buxhetore
- Në **arsimin fillor** janë shpenzuar 98.77% ndërsa
- Në **arsimin e mesëm** 99.55 % .
- Gjithashtu Drejtoria e Arsimit ka pasur në dispozicion të hyra vetanake për 2024-shin dhe të hyra të bartura të vitit 2023 cilat janë

shpenzuar 97 përkatësisht 98 % e mjeteve të alokuara të tyre.

- Për të pasur një pasqyrë më të detajuar të shpenzimeve sipas të gjitha kategorive dhe burimeve, bashkangjitur keni raportin përmbledhës të buxhetit për periudhën janar – dhjetor, datë. 31.12.2024

II. Aktivitetet në periudhën janar – dhjetor 2024

Krahas aktiviteteve me nxënës të cilat i organizojnë shkollat, DKA ka organizuar gara dhe aktivitete të ndryshme me nxënës me qëllim të arritjes së mobilizimit më të madh, për rritje të cilësisë në arsim, të gjithpërfshirjes dhe të dinamizimit në jetën shkollore.

- **Garat Komunale dhe Republikane të Fizikanit të Ri 2024**

Shoqata e Fizikanëve të Kosovës në bashkëpunim me MASHTI-n dhe DKA ka organizuar garat shkollore dhe komunale, ku edhe janë zgjedhur nxënësit fitues nga Komuna e Prizrenit për në garat e XIV Republikane të Fizikanit të Ri 2023 *të klasëve të 9-ta, 10-ta, 11-ta dhe 12-ta.*

- **Garat Komunale të Olimpjadës së Matematikës për vitin 2024**

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren ka organizuar garat shkollore me nxënësit e klasës së 8, 9, 10, 11, dhe 12. Në gara kanë marrë pjesë nxënës edhe të komunitetit boshnjak dhe turk.

- **Testi i arritshmërisë 2024**

Testi i arritshmërisë u organizuar nga MASHTI në bashkëpunim me DKA-në në Prizren të cilit iu kanë nështruar 2210 nxënës të klasave të nënta për vitin shkollor 2023/2024. Testimi është kryer në dy faza . Në 25 qershor testimi është mbajtur në lëndët gjuha amtare, gjuha angleze, historia dhe gjeografia, ndërsa më 28 qershor janë testuar njohuritë në lëndën e matematikës, informatikës, kimisë, fizikës dhe biologjisë.

I. Regjistrimi i nxënësve në klasë të dhjetë (10) për vitin shkollor 2023/2024

Është bërë planifikimi i drejtimeve, profileve, paraleleve dhe numrit të nxënësve për regjistrim të nxënësve në klasë të dhjetë për vitin shkollor 2024/2025, në pesë (5) shkollat e mesme të larta që menaxhohen nga DKA në Prizren. Me

drejtorët e shkollave të mesme të larta është diskutuar për planifikimet e shkollave sipas vendimit të MASHTI-t, duke mos cënuar kuadrin e shkollës dhe duke marrë parasysh numrin e nxënësve në rënie nga klasa e nëntë (9).

Numri i nxënësve të planifikuar për regjistrim në klasë të dhjetë (10) në pesë shkollat e mesme të larta është 1487 nxënës, nga të cilët 1239 shqiptarë, 164 boshnjakë dhe 84 turq.

II. Aktivitet: 7 Marsi – Dita e Mësuesit dhe Java Remzi Ademaj-Shtigjeve të Lirisë

-Dita e Mësuesit

Është mbajtur program festiv me nxënës të shkollave në qendren “Evropa” në Prizren me rastin e “7 marsit”. Në këtë aktivitet mësime të pensionistëve të vitit 2023-2024 i është shpërndarë mirënjohje dhe shpërblime. Po ashtu i janë dhënë mirënjohje dhe shpërblime nxënësve fitues në garat komunale, si në garat e Olimpiadës së Matematikës dhe të Fizikanit të Ri.

-Java Remzi Ademaj – Shtigjeve të Lirisë

Është mbajtur aktiviteti i Javës Remzi Ademaj Shtigjeve të Lirisë në qershor të vitit 2024 ku kanë garuar nxënësit në 12 disiplina.

III. MATURA SHETËRORE 2024

Është organizuar testi i Maturës Shtetërore 2024, në dy faza. Testit i janë nënshtruar 1926 maturantë nga të cilët 1960 maturantë të komunitetit shqiptar, 128 maturantë të komunitetit boshnjak dhe 108 maturantë të komunitetit turk.

Në bazë të Ligjit mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018, UA 04/2016 dhe UA 05/2016 Detyrat dhe përgjegjësit e administrueseve dhe komisioneve të qendrave të testimit, Vendimit të Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me nr. 01B-039 të datës 17.04.2024, njoftimit të DVSM në MASHTI për mënyrën e paraqitjes së provimit të maturës përmes platformës e-Kosova, DKA në Prizren ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme organizative për mbajtjen e Maturës Shtetërore 2024, që u mbajt më 22 qershor 2024.


Sipas udhëzimeve të DVSM në MASHTI, prej DKA është kërkuar të caktohen koordinatorët e shkollave për Maturën Shtetërore, ku

pastaj nxënësit individualisht pasi janë regjistruar në platformën e-Kosova, kanë paraqitur provimin e maturës, dhe DVSM ka shpërndarë listën e nxënësve të të gjitha shkollave nëpër qendrat e ndryshme të testimit. Përmes platformës e-Kosova kanë paraqitur provimin 1926 maturantë nga të gjitha shkollat e mesme të larta të Komunës së Prizrenit.

Nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren janë caktuar 16 Qendra të Testimit dhe janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për mbarëvajtje më të mirë të maturës shtetërore.

Testit do të nënshtrohen 1926 maturantë dhe atë 1690 maturantë të komunitetit shqiptarë, 128 maturantë të komunitetit boshnjak dhe 108 maturantë të komunitetit turk. Janë caktuar komisionet e DKA-së nëpër Qendra të Testimit dhe 63 administruesit e Provimit të Maturës Shtetërore nga shkollat e komunës sonë kanë administruar Testin e Maturës Shtetërore në komunat e Suharekës, Dragashit dhe të Mamushës.

Në të gjitha Qendrat e Testimit procesi ka shkuar në nivel të mirë, përjashtimisht në disa qendra testimi ka filluar me vonesë, për shkak të vonesës së komisioneve dhe testeve nga MASHTI.



REZULTATI I TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE Afati Qershor 2024

Rezultati i Maturës Afati_qershor 2024		Nxënësit që kanë hy në test			Nxënës që kaluan testin		
Nr.	Shkolla	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	134	211	345	131	203	334
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	87	197	284	71	131	202
3	SHMM "Luciano Motroni"	91	289	380	82	250	332
4	SHME "Ymer Prizreni"	101	92	193	69	37	106
5	SHMM "Lorenc Antoni"	15	15	30	10	12	22
6	Qendra e Kompetencës	17	23	40	13	12	25
7	SHMT "11 Marsi"	223	117	340	155	71	226
8	Medreseja "Alauddin"	12	34	46	11	25	36
9	"Loyola" Gymnazium	49	59	108	49	59	108
10	College "Mehmet Akif"	18	28	46	16	23	39
11	Maarif School International	16	20	36	13	18	31
12	Q.B. "Nënë Tereza"	2	1	3	1	0	1
Gjithsej		765	1086	1851	621	841	1462
					81.18	77.44	78.98
					%meshkuj	%femra	

REZULTATI I TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE Afati Gushtit 2024

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN REZULTATI I TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE 2024

Rezultati i Maturës Shtetërore 2024 per dy afate, Qershor - Gusht		Nxënësit që kanë hy në test në dy afate, qershor - gusht 2024			Nxënës që kaluan testin në dy afate qershor - gusht 2024			Përqindja e kalueshmërisë (mbi 40% e pragut)
Nr.	Shkolla	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku" shqip	83	164	247	81	163	244	98.79
	Gjimnazi "Gjon Buzuku" boshnjak	29	16	45	29	16	45	100.00
	Gjimnazi "Gjon Buzuku" turk	22	31	53	22	31	53	100.00
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	88	169	257	81	160	241	93.77
3	SHMM "Luciano Motroni" shqip	79	278	357	75	280	355	99.44
	SHMM "Luciano Motroni" boshnjak	12	30	42	12	30	42	100.00
	SHMM "Luciano Motroni" turk	9	21	30	9	21	30	100.00
4	SHME "Ymer Prizreni" shqip	114	110	224	75	51	126	56.25
	SHME "Ymer Prizreni" boshnjak	7	2	9	4	1	5	55.56
	SHME "Ymer Prizreni" turk	10	7	17	7	4	11	64.71
5	SHMM "Lorenc Antoni"	15	15	30	13	15	28	93.33
6	Qendra e Kompetencës	20	29	49	15	16	31	63.27
7	SHMT "11 Marsi" shqip	249	123	372	163	70	233	62.63
	SHMT "11 Marsi" boshnjak	21	13	34	19	13	32	94.12
	SHMT "11 Marsi" turk	11	11	22	9	7	16	72.73
8	Medreseja "Alauddin"	17	44	61	15	28	43	70.49
9	"Loyola" Gymnazium	49	59	108	49	59	108	100.00
10	College "Mehmet Akif"	18	28	46	18	28	46	100.00
11	Maarif School International	16	20	36	15	20	35	97.22
12	Q.B. "Nënë Tereza"	2	1	3	2	1	3	100.00
	Gjithsej	871	1171	2042	713	1014	1727	84.57

	Shqip	Boshnjak	Turk	Total
Gjithsej nx.	1790	130	122	2042
Kaluan provimin	1493	124	110	1727
Kalueshmëria%	83.41	95.38	90.16	84.57

Prizren,
Shtator 2024

Nexhat Maçkaj
Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë

Testi PISA 2024 (Pilotimi)

Janë mbajtur takime në DKA me DVSM të MASHTI (Fatmir Elezi, Birsën Shufta), koordinator dhe drejtorë të shkollave të mesme të larta, Gjinnazi “Gjon Buzuku” dhe IAAP “Ymer Prizreni” në Prizren, dhe me drejtorë të Komunave Suharekë, Dragash dhe Mamushë, lidhur me organizimin e testit PISA (pilotim);

Testit PISA në pilotim do të nënshtrohen nxënës të gjeneratës I janar - 31 dhjetor 2008 dhe u mbajtën nga data 5 nëntor deri me datë 7 nëntor 2024;

Testi është mbajtur online në fushën e gjuhës, matematikës dhe shkencës;

Në test në mënyrë të rastësishtme marën pjesë nga 87 nxënës të të dy shkollave Gjinnazi “Gjon Buzuku” dhe IAAP “Ymer Prizreni” në Prizren;



IV. Aktivitet: Panairi me Universite/Kolegje Amerikane - EdUSA University Fair

Nxënës të dalluar nga shkollat e mesme të larta, kanë parë nga afër mundësitë e studimeve në Amerikë, në panairin e universiteteve dhe kolegjeve amerikane të organizuar nga ambasada amerikane - EdUSA University Fair - Kosovo. Ky panair ka ofruar informacione të vlefshme mbi programet e studimit, mundësi të bursave dhe ndihmës financiare, si dhe mundësinë e komunikimit me përfaqësues të universiteteve nga SHBA- të.

V. Punëtori lidhur me Planin Zhvillimor të Arsimit në Komunë - PZHKA 2024 – 2027

Plani për Zhvillimin e Arsimit në Komunën e Prizrenit 2024-2027 është hartuar sipas vendimit të DKA-së bazuar në dokumente të rëndësishme legislative dhe strategjike në nivel qendror. Plani ka përcaktuar objektivat e

zhvillimit të sistemit të arsimit parauniversitar në Komunën e Prizrenit gjatë periudhës 2024-2027, të cilat i kanë bashkërendisur politikat arsimore të nivelit qendror me prioritetet zhvillimore të këtij sektori të përcaktuara në nivelin komunal. Për të siguruar harmonizimin e këtij plani me politikat qendrore dhe të interesave komunale, hartimi i planit është punuar përmes një procesi me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha strukturave me interes në sferën e arsimit..

VIV. Zbatimi në praktikë i Kurrikulës së Re dhe vlerësimi i kompetencave

Trajnimet janë mbajtur me të gjithë mësimdhënësit e rinj nga konkurset e fundit të organizuar në komunën e Prizrenit. Janë mbajtur trajnimet gjashtë (6) ditore dhe është diskutuar lidhur me zbatimin e kurrikulës së re në shkollat e komunës si dhe marrjen e të dhënave për vlerësimin e formulimin e një pyetësori online për marrjen e informatave nga shkollat në kuadër të caktimit të nevojave të shkollave për përgatitjet e vlerësimit të kompetencave – vlerësimi për shkallë kurrikulare në nivel komune.

XV. Flutura Academy

Në bashkëpunim me agjencinë Flutura është punuar me shkathtësimin e nxënësve dhe të rinjve për përdorimin e teknologjisë informative, në zhvillimin e aplikacioneve digjitale dhe ... Akademisë i është dhënë në shfrytëzim një pjesë e ShFMU "Lidhja e Prizrenit", të cilën Akademia e ka pajisur me mjete të teknologjisë digjitale të cilat do të jenë në shfrytëzim të komunitetit arsimor.

XVI. Mësimi për të rritur

Drejtorja e Arsimit ka nisur me projektin e arsimit për të rritur, gjegjësisht arsimin joformal. Shumë qytetarë, të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të përfundojnë arsimin e detyrueshëm, kanë shprehur interesimin që të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, si e drejtë themelore e tyre. Për këtë arsye DKA ka nisur me procesin e përfshirjes së qytetarëve të interesuar në këtë projekt cili po vazhdon.

XVII. Your Job / Puna juaj

Së bashku me partnerin Caritas Kosova e gjithë moshë rinore do të përfitojë nga programet që ofron Caritasi i Kosovës lidhur me orientimin në karrierë dhe ndërtimin e shkathtësive të buta. Drejtorja e arsimit ka ofruar të gjitha parakushtet në

mënyrë që të përfitojë një numër sa më i madh i të rinjve nga shkollat tona.

XVIII. Përkrahja e mësimdhënësve klasorë

Për ta mbështetur punën e mësimdhënësve janë angazhuar pesë (5) psikologë profesionistë, të kualifikuar edhe si mësimdhënës, për të mbështetur mësimdhënësit klasorë të përballojnë sfidat në punë me nxënësit në nevojë dhe ata me nevoja të veçanta, përfshirë nxënësit e komuniteteve pakicë që kanë vështirësi në të nxënë.

XIX. Asistenca për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore

Përmes programit të Caritas Kosova për të përkrahur nxënësit në nevojë dhe ata me nevoja të veçanta arsimore, Drejtoria e Arsimit ka vazhduar angazhimin e 8 psikologëve shtesë të cilët do të shpërndahen në shkollat e komunës për të ofruar shërbimet themelore psikologjike për fëmijët dhe personelin arsimor.

XX. Një robot për çdo fëmijë

Në bashkëpunim me Kosova Markers League, 43 shkolla fillore kanë përfituar pajisje dhe kurse/trajnime për zhvillimin e robotikës dhe koncepteve digjitale. Për t'iu përgjigjur nevojave të kohës, mësimdhënësit dhe nxënësit do të aplikojnë së bashku pajisjet digjitale / robotët në funksion të rritjes së cilësisë.

XXI. Rritja e sigurisë në shkolla

Në bashkëpunim me policinë e Kosovës janë mbajtur ligjërata me tema të ndryshme në shkolla për sigurinë.

II. Infrastruktura në institucionet arsimore

Njësia teknike pranë DKA-së ka vazhduar punime me realizimin e projekteve dhe planifikimin e projekteve të reja, përfshirë furnizimin me mallra dhe dhënie të shërbimeve të shkollave, si dhe ka monitoruar punimet (nga investimet kapitale) që janë bërë në ndërtimin e objekteve shkollore si dhe rinovimin e tyre. Janë realizuar aktivitete të ndryshme si vijon:

1. Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Pllanjane" në Pllanjanë
(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 59,746.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 54,185.06€ / 90.69% realizim)


Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve. Po ashtu është realizuar edhe pagesa përfundimtare dhe objekti është funksionalizuar.



2. Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish Pjeter Mazrreku) në Mazrrek

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 140,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 140,000.00€ / 100.00% realizim)

Punimet për momentin janë ndërprerë për mungesë të mjeteve financiare. Deri më tani janë realizuar kryesisht punimet e vrazhda të betonit në tri nivele-etazhe. Poashtu etazha e parë dhe e dyte pjesërisht janë muratuar. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2025.



3. Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushe të Vogël

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 191,589.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 191,584.50€ / 99.99% realizim)


Punimet janë duke vazhduar. Poashtu është kontraktuar edhe faza e dytë e realizimit të punimeve. Punimet e fazës së parë pritet të përfundojnë gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, ndërsa për punimet e fazës së dytë, deri në fund të vitit 2025. Objekti, sipas planifikimit, do të jetë në funksionim gjatë fund vitit 2025.



4. Ndertimi i aneksit te shkolles ne Vermice

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 223,333.00€. Jane realizuar pagesat ne vlerë prej 223,333.00€ / 100.00% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve dhe objekti është funksionalizuar. Pagesa përfundimtare do të realizohet gjate vitit 2025 sipas planifikimit të buxhetit.





5. **Ndërtimi I sallës së edukatës fizike në shkollën "Haziz Tola" në Lagjen Jeta e Re - Prizren - faza e dytë**
(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 67,147.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 67,147.00€ / 100% realizim)
Te gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.



6. Ndërtimi I sallës së edukatës fizike në shkollën "Fatmir Berisha" në Lagjen Bajram Curri - Prizren - faza e dytë

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 75,555.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 59,998.27€ / 79.41% realizim)

Punimet janë ndërpre nga ana e Operatorit Ekonomik. Për këtë arsye OE i janë dhënë dy vërejtje me shkrim.



7. Ndërtimi I aneksit të shkolles së mesme në Romajë – Has

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 139,088.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 138,215.77€ / 99.37% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve dhe objekti është funksionalizuar. Pagesa përfundimtare do të realizohet gjatë vitit 2025 sipas planifikimit të buxhetit.



8. Renovimi I teresishem I objektit shkollor "Gernqare" Novoselan

(Mjetet e planifikuara per vitin 2023 ne vlere prej 78,148.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 78,148.00€ / 100.00% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve. Po ashtu është realizuar edhe pagesa përfundimtare.




9. Rregullimi I ambientit te oborreve ne shkollat e Prizrenit

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 100,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 100,000.00€ / 100% realizim)

Janë realizuar punimet në rregullimin e ambienteve të oborreve në shkollat “Zenun Çoçaj” në Gjonaj, “Dëshmorët e Kabashit” në Korishë dhe “Gani Saramati” Prizren dhe “Naim Frashëri” Kobaj. Pra me këtë edhe kontrata është realizu në përgjithësi.

Sipas marrëveshjes gjentëlmene, OE, mjetet financiare në vlerë prej 141,629.33€, i ka marrë përmes përmabruesit.



10. Ndertimi I aneksit te shkolles "Besim Ndrecaj" Lutogllave

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 50,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 50,000.00€ / 100% realizim)

Deri më tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka) te aneksit te perdheses dhe etazhës. Pastaj eshte vazhduar edhe me suvatime dhe pune tjera ndertimore dhe zejtare. Për momentin punimet janë ndërprerë në mungesë të mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, ndoshta do të zgjasin deri në vitin 2026.




11. Renovimi I objektit shkollor SHF "Lekë Dukagjini" Prizren

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 104,528.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 104,528.00€ / 100.00% realizim)

Te gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

Pas realizimit të punimeve sipas kontratës, duhet cekur sa ka mungesë buxheti në vlerë prej 16,800.00€, të cilat mjete janë planifikuar ne buxhetin e vitit 2025.





12. Ndërtimi i qerdhes ne Lagjen Tusus Prizren

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 250,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 250,000.00€ / 100% realizim)

Deri me tani jane realizuar punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka) te bodrumit, përdhësës dhe etazhës, të njëres pjesë të objektit. Per momentin punimet jane nderprere ne mungese te mungese te mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2026





13. Renovimi i teresishem i salles se edukates fizike "Meto Bajraktari" ne Recane

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 68,312.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 67,697.78€ / 99.10% realizim)

Projekti i filluar nga viti 2022, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare është shtyer deri në vitin 2024. Te gjitha punimet jane realizuar dhe eshte bere pranimi teknik.

14. Ndërtimi I qerdhes ne Fshatin Zhur Prizren

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 50,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2027.

15. Ndërtimi i qerdhes ne Lagjen Arbana Prizren

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 80,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2027.

16. Ndertimi i aneksit per parashkollor ne SHFMU "Motrata Qiriazhi" Prizren

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 50,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024, i propozuar nga komuniteti, nuk ka kushte-hapësirë të mjaftueshme për ndërtim.

Nga analiza dhe bisedat, projekti në fjalë është anuluar në tërësi.

17. Renovimi i teresishem i obj.shk. "Mati Logoreci" Prizren

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 50,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në procedure tenderimi. Ky projekt eshte planifikuar si projekt 3 vjecarë.

18. Renovimi i nyjeve sanitare ne objektet shkollore: Ibrahim Fehmiu dhe Deshmoret e Kabashit

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 50,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 50,000€ / 100,00% realizim)

Projekti i planifikuar ka filluar por ne mungese te mjeteve do te vazhdoje edhe gjate vitit 2025.

19. Ndertimi i terrenit sportiv dhe murit mbrojtës ne shkollen "Deshmoret e Zhurit" ne Zhur

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 100,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 77,500.00€ /100% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve. Po ashtu është realizuar edhe pagesa përfundimtare.

20. Ndertimi dhe rregullimi i stadiumit ne shkollen "Meto Bajraktari" ne Recane

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 50,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 50,000.00€ / 100% realizim)

Projekti ka filluar se implementuari. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, mund të zgjasin deri në vitin 2025.

21. Ndertimi i kendit te lojrave ne SHFMU "Motrat Qiriazhi" lagj.Kurile Prizren

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 20,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 13,803.59€ / 100% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve. Po ashtu është realizuar edhe pagesa përfundimtare.

22. Ndertimi i ashensorit ne SHFMU"Motrat Qiriazhi" lagj.Kurile Prizren

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 30,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj gjatë muajit dhjetor të vitit 2024, për shkak të procedurave të prokurimit.

23. Ndririmi i kalldajave ngrohjes qendrore, montimi i pompave termike ne SHFMU"Motrat Qiriazhi" lagj.Kurile Prizren

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 50,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti është anuluar dhe për vitin buxhtor 2025 është planifikuar të realizohet me ndryshim, ku ne vend të pompave termike është planifikuar të montohen kalldajat me pelet.

Gjatë vitit 2024 janë planifikuar edhe 5 projekte tjera (nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime) si më poshtë:

1. Hartimi I projektevetë ndryshme për nevojat e DKA, për vitin 2024 e planifikuar ne vlerë prej 100,000.00€. Projekti është në fazën e konsolidimit të ekipit për fillimin e hartimit të projekteve.
2. Mirëmbajtja e sistemit te ngrohjes qendrore neper instucionet arsimore te Komunes se Prizrenit. Për vitin 2024 e planifikuar dhe e kontraktuar ne vlerë prej 100,000.00€. Kontrata eshte nenshkruar dhe varesisht nga kerkesat e shkollave ka filluar së implementuari.
3. Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambientit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit - kontratë kornizë. E planifikuar për tri vite, ne vlerë prej 1,500,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.
4. Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) të institucioneve arsimore. E planifikuar për tri vite, ne vlerë prej 889,750.00€. Kontrata eshte nenshkruar dhe varesisht nga kerkesat e shkollave ka filluar së implementuari.
5. Furnizimi me inventar shkollor për institucionet arsimore. Për vitin 2024 e planifikuar ne vlerë prej 95,000.00€. Kontrata eshte nenshkruar dhe e implementuar në tërësi.